



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT TË NDËRMARRJES PUBLIKE  
“HORTIKULTURA” SH.A PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31  
DHJETOR 2018**

**Prishtinë, qershor 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të "Hortikultura" sh.a në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Florim Maliqi dhe anëtarja e ekipit Valbona Pllana, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Qeverisja e mirë.....	25
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	28
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	33
Shtojca II: Letër Konfirmimi .....	36

## Përmbledhje e përgjithshme

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike Hortikultura sh.a për vitin 2018, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 21.02.2019.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Hortikulturës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i Kualifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinionëve, sipas SNISA-ve.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

Opinionit i Kualifikuar është rezultat i mungesës së një marrëveshje në mes të Hortikulturës dhe Komunës së Prishtinës për të drejtat dhe obligimet për pasuritë e pranuar si donacion.



Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se menaxhmenti i Hortikulturës dhe ai i Komunës së Prishtinës dakordohen për një marrëveshje për definimin e të drejtave dhe obligimeve për pasuritë e marra si donacion.

(shih çështjet te Baza për Opinon).

Avancet e dhëna pa bazë ligjore, regjistrimi i gabuar i shpenzimeve të sigurimit, blerja pa parokurim dhe ndarja e prokurimeve pasqyrojnë kontrollet jo adekuate në Kompani.



Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj forcimin e kontroleve të brendshme me qëllim të mos përsëritjes së gabimeve të theksuara në këtë raport.

(shih çështjet B3, A3 deri A7).

Pagesa e honorarave pa aprovim të aksionarit dhe proceset e dobëta të rekrutimit paraqesin dobësi në menaxhimin e parasë publike dhe jo transparence në rekrutimin e burimeve njerzore.



Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se nuk do të paguhen honorare pa aprovim të aksionarit dhe zyra e burimeve njerzore merrë parasysh dhe zbaton kriteret për rekrutim të puntorëve të rinjë.

(shih çështjet A8 & A9).

Mungesa e komisionit të auditimit dhe bordit të drejtorëve për një kohë të gjatë, kanë ndikuar në shfaqjen e dobësive në kontrollet e brendshme që kanë të bëjnë me auditimin e brendshëm dhe hartimin e listës së rreziqeve.



Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë funksionim të mirëfilltë të fushës së auditimit të brendshëm, dhe të fillojë me procesin e hartimit të planit për menaxhim të rreziqeve. (shih çështjet C1 dhe B5).

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me të gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të NP Hortikultura sh.a, gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Hortikulturës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshafi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i kualifikuar

Kemi audituar PFV-të NP "Hortikultura" për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare vjetore paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të NP "Hortikultura" për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parmit aktual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

#### Baza për opinion të kualifikuar

Ne kemi krijuar bazën për opinion të kualifikuar, për arsyt e përmendura në vijim:

- Korniza Konceptuale për Raportimin Financiar (paragrafi 4.4 a), përcakton se: një aktiv është një burim i kontrolluar nga njësia ekonomike si rezultat i ngjarjeve në të shkuarën nga të cilat parashikohen përfitime ekonomike të ardhshme që do futen në njësinë ekonomike. Respektivisht paragrafi 4.6 përcakton se gjatë vlerësimit, nëse një zë e plotëson përkufizimin e një aktivi, duhet ti kushtohet vëmendje përmbajtjes themelore të tij dhe realitetit ekonomik dhe jo vetëm formës së tij ligjore. Me datën 23.11.2018, me

një komision të përbashkët të Komunës së Prishtinës dhe Hortikulturës është bërë dorëzim pranimit i disa pajisjeve pune (2 kamion, 2 traktor dhe 1 cisterne) dhe pajisjeve tjera pa definuar vlerën e tyre. Vlera e këtyre pasurive është materiale edhe pse nuk dihet me saktësi sa është kjo vlerë. Këto pasuri fikse nuk janë të regjistruara në listën e pasurive të ndërmarrjes, për shkak të mungesës së dokumenteve burimore dhe mungesës një marrëveshje për përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërmarrjes për këto pasuri. Ndërmarrja kishte kërkuar dokumentet e nevojshme për regjistrimin e pasurive të pranuar nga komuna e Prishtinës, mirëpo me gjithë përpjekjet e Kompanisë këto dokumente nuk ishin ofruar ende nga Komuna;

- Hortikulturë gjatë viteve 2013-2017 kishte pranuar nga Komuna e Prishtinës pajisje të ndryshme në vlerë 512,772€. Megjithëse nga këto pasuri rrjedhin përfitime ekonomike në drejtim të Hortikulturës si rezultat i shfrytëzimit të tyre. Ndërmarrja nuk i kishte të regjistruara në regjistrat e saj, por këto pasuri mbahen në regjistrat e pasurive të Komunës së Prishtinës. Kjo kishte ndodhur për shkak se këtij procesi nuk i kishte paraprirë një dokumentim (marrëveshje), ku do të specifikoheshin obligimet dhe të drejtat e të dyja palëve, por vetëm një proces i pranim dorëzimit të këtyre pasurive jo qarkulluese. Lidhur me këtë çështje ekziston një shkresë që i është drejtuar Komunës së Prishtinës duke i kërkuar të lidhet një marrëveshje ku do të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve për pasuritë e pranuar si donacion. Megjithatë, deri në kohën sa ne ishim në auditim Komuna nuk ka reaguar ndaj kësaj kërkesë dhe rrjedhimisht, nuk ka pasur lëvizje pozitive në këtë drejtim; dhe
- Hapësira për zyre e cila është në pronësi të Komunës së Prishtinës i është dhënë në shfrytëzim Hortikulturës, në bazë të një marrëveshje për përdorim të përkohshëm, por kostoja e kësaj pasurie nuk ishte njohur, matur dhe regjistruar si pasuri e ndërmarrjes në përputhje me SNK 20.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe Ndërmarrjeve Publike në Kosovë. ZKA është e pavarur nga Hortikultura dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit akruar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe



---

Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP-së.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim**

Nga NP kërkohet të veprojnë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;

- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L- 42 për Prokurimin Publik (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përmbush edhe kërkesat në vijim:
  - Statutin e NP-së;
  - Planin e Biznesit;
  - Raportet tremujore;
  - Raporte vjetore;
  - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
  - Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga KE dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtove mund të konsiderohen të sakta. Përveç çështjeve të lartë përmendura, PFV-të paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi A1**<sup>1</sup> Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se të gjitha aktivet e kontrolluara nga ndërmarrja dhe nga të cilat parashikon të ketë përfitime ekonomike prezantohen në PFV.

**Rekomandimi B1** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se në bashkëpunim me menaxhmentin e Komunës së Prishtinës dakordohen për një marrëveshje për përcaktimin e kushteve lidhur me të drejtët dhe obligimet për pasuritë e pranuar si donacion.

**Rekomandimi A2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se hapësira për zyre që e shfrytëzon Hortikultura edhe pse është pronë e Komunës së Prishtinës, kostoja e saj duhet të njihet, të matet dhe të regjistrohet si pasuri e ndërmarrjes në përputhje me SNK 20.

<sup>1</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja, Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura, Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Ndërmarrjen Publike "Hortikultura". Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së NP-së që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Kontrollat mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë në fushën e shpenzimeve.

Mos regjistrimi i shpenzimeve sipas parimit aktual, procedurat e pa planifikuara të prokurimit për pajisjet, blerjet e mobileve dhe pajisjeve pa procedura të prokurimit dhe mos regjistrimi i aseteve fikse janë fusha të cilat duhet të trajtohen me kujdes nga menaxhmenti. Më tutje, ekzaminimet tona të auditimit kanë identifikuar dobësi edhe në procesin e rekrutimit dhe në pagesat për mbledhjet e mbajtura nga bordi i drejtorëve të cilat nuk ishin në harmoni me ligjet në fuqi.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga Bordi i Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin tek Hortikultura.

#### 3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2018 (në €)**

Përshkrimi	Planifikim i fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Të hyrat nga mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese në qytetin e Prishtinës	1,400,000	1,357,081	1,170,660	964,856
Të hyrat nga varrezat e qytetit të Prishtinës	65,000	65,000	64,355	61,078
Të hyrat nga subvencionet	0	5,100	7,470	0
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>1,465,000</b>	<b>1,427,181</b>	<b>1,242,485</b>	<b>1,025,934</b>
Shpenzimet për paga	1,005,040	1,005,040	941,941	855,339
Shpenzimet operative	373,277	373,277	137,779	82,850

Shpenzimet tjera	18,048 <sup>2</sup>	18,048	6,319 <sup>3</sup>	8,033
Shpenzimet e zhvlerësimit	0	0	11,498	11,978
Investimet kapitale	34,300	0	0	0
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>1,430,665</b>	<b>1,396,365</b>	<b>1,097,357</b>	<b>958,200</b>

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë në vijim:

- Me plan fillestar të biznesit nga mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese janë paraparë të hyrat në shumë prej 1,400,000€, deri sa me rishikim janë reduktuar për 42,919€ apo rreth 3% më pak. Pavarësisht kësaj, këto të hyrat janë realizuar 1,170,660€ apo 14% më pak se sa ishin paraparë në planin final;
- Të hyrat nga varrezat e qytetit të Prishtinës nuk kishin ndryshuar me rishikim të planit dhe ishin realizuar në masën 99%;
- Të hyrat nga subvencionet me plan fillestar nuk janë paraparë të realizohen, ndërsa me rishikim është përfshirë shuma prej 5,100€. Sipas zyrtareve kjo shumë është planifikuar me rishikim të buxhetit si rezultat i një kontrate të nënshkruar me donatorin "Care" (Agjencinë Austriake për Zhvillim) lidhur me projektin "Tregu mobil i fermerëve" në komunën e Prishtinës. Kontrata është lidhur me datën 09.02.2018, në shumë prej 9,960€ e cila është paraparë të paguhet në tri këste në vitin 2018 dhe një këst në vitin 2019. Pavarësisht kësaj, në llogari të ndërmarrjes janë paguar tre këstet e parapara me kontratë në shumë prej 7,470€. Ndryshimi në mes buxhetit dhe shumës së përfutur është 2,370€, e cila ka rezultuar nga mos shqyrtimi/vlerësimi i saktë i kësteve të cilat i ka paraparë kontrata me donatorin;
- Plani fillestar me atë të rishikuar nuk ka pasur ndryshim për paga dhe mëditje, shpenzime operative dhe shpenzime tjera, ndërsa realizimi i tyre në raport me planin e rishikuar ishin: shpenzimet për paga 94%, shpenzimet operative 37% dhe shpenzimet tjera 35%; dhe
- Me plan fillestar për investime kapitale ishin paraparë 34,300€ (freza, mjete pune, kositëse me penjës, inventarë, kosa rotative, sharra motorike) por, me rishikim të buxhetit këto investime kapitale në planin final nuk janë përfshirë pasi disa pajisje të planifikuara janë pranuar si donacion nga Komuna e Prishtinës.

<sup>2</sup> Shpenzimet tjera: shpenzimet kontraktuese 10,648€, provizionet e bankës 650€, reprezentacion 6,000€ dhe shtypi ditor 750€.

<sup>3</sup> Shpenzimet tjera: shpenzimet për provizione 1,281€, shpenzimet e reprezentacionit 4,855€ dhe shpenzimet për konkurse 183€.

**Çështja A3 - Mos realizimi i buxhetit sipas planit të biznesit**

- Gjetja** Realizimi i të hyrave nga mirëmbajtja e sipërfaqeve gjelbëruese ishte vetëm 86% nga planifikimi i rishikuar për vitin 2018, por krahasuar me vitin 2017 kishte një rritje prej 21% nga kjo e hyrë. Sipas të dhënave shihet se ekzekutimi i buxhetit për shpenzimet totale është 78%. Ndërsa shpenzimet operative ishin 137,779 apo 37% të planit të rishikuar. Kjo për shkak të mungesës së planifikimit dhe kontrollit sistematik të ecurive buxhetore të Hortikulturës.
- Rreziku** Ekzekutimi i buxhetit në nivel jo të duhur mund të rezultojë me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion, redukton efektivitetin e planeve të shpenzimeve dhe shkakton ngecje në ushtrimin e veprimtarisë së ndërmarrjes në përgjithësi.
- Rekomandimi A3** Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për shpenzimet operative dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit në bazë të një analize me të hollësishme rreth planifikimit dhe realizimit të buxhetit.

## 3.2 Pasqyra e pozitës financiare

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrës së pozitës financiare, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

**Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare e NP "Hortikultura" më 31 dhjetor 2018 (në €)**

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017
Prona, pajisjet dhe impiantet	38,128	47,547
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	199,773	186,056
Paraja në bankë dhe arkë	309,175	175,294
<b>Gjithsej Pasuritë</b>	<b>547,076</b>	<b>408,897</b>
<b>Ekuiteti</b>		
Kapitali aksionar	10,000	10,000
Kapitali rezerve	111,762	111,722
Fitimet/Humbjet e mbajtura	259,107	198,146
Fitimet/Humbjet e vitit	130,454	60,960
<b>Detyrimet</b>		
Llogaritë e pagueshme tregtare	3,495	3,430
Obligime për tatime dhe kontribute	32,258	24,639
<b>Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti</b>	<b>547,076</b>	<b>408,897</b>

---

## Çështja B2 - Avancat e dhëna për punëtorët

Për aprovimin e kërkesave të punëtorëve për pranimin e avancave, duhet të ketë një politikë apo udhëzim të brendshëm ku do të përcaktohen vlerat e avancave dhe kriteret e dhënies. Kryeshefi Ekzekutiv kishte aprovuar kërkesat e punonjësve për tu dhënë avance në shumë prej 50€ e deri në 100€ në të gatshme. Sipas librit kryesor për vitin 2018 janë dhënë avance në vlerë 15,009€, ku prej kësaj shume për punëtorët e ndërmarrjes janë dhënë 14,489€. Ndërmarrja nuk kishte një bazë ligjore apo politikë të shkruar për dhënien e avancave ndaj punëtorëve. Kjo ka ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk kishte bord të drejtorëve nga viti 2013 deri në shtator 2018.

**Rreziku** Dhënia e avancave ndaj punëtorëve, përveç së është e pa bazë ligjore, mund të ketë si rrezik mos kthimin e mjeteve në llogarinë e ndërmarrjes.

**Rekomandimi B2** Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprime konkrete për parandalimin e dhënies së avancave ndaj punëtorëve pa bazë ligjore.

## Çështja A4 - Regjistrimi i gabuar i shpenzimeve të parapaguara

**Gjetja** Sipas parimit akrual të kontabilitetit efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike tjera duhet të njihen në momentin e ndodhjes dhe ato duhet të regjistrohen në regjistrat e kontabilitetit dhe raportohen në pasqyrat financiare në periudhën të cilës i takojnë. Gjatë testimit të shpenzimeve kemi gjetur se në fund të vitit 2018 janë regjistruar si shpenzime të sigurimit të automjeteve 826€ të cilat do duhej të regjistrohen si parapagime. Regjistrimi i gabuar i shpenzimeve të parapaguara të automjeteve ka ndodhur për shkak se zyrtaret financiar e kanë konsideruar këtë vlerë si shpenzim të periudhës.

**Rreziku** Mungesa e interpretimit të drejtë të SNK1 ka bërë që parapagimi të regjistrohet si shpenzim i periudhës dhe rrjedhimisht të mos prezantohen drejtë zërat e PFV-ve.

**Rekomandimi A4** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroi që zyra e financave regjistrojnë të gjitha transaksionet në mënyrë të drejtë, duke interpretuar drejtë standardet e kontabilitetit, dhe të bëhen rregullimet e nevojshme duke bërë prerjen/regjistrimin e shpenzimeve të cilat i takojnë vetëm periudhës kontabël.

---

## Çështja A5 - Regjistri i pasurive fikse jo i plotë

- Gjetja** Regjistri i përgjithshëm i pasurive fikse është një listë e plotë dhe e saktë e të gjitha pasurive të zotëruara nga ndërmarrja, që nënkupton regjistrin e pasurive kapitale, pasurive jo kapitale dhe stoqeve që azhurnohen rregullisht. Ky regjistër përveç përdorimit për menaxhimin e pasurive do të përdoret edhe për të mbështetur të dhënat e raportuara në pasqyrat financiare. Hortikultura ka një regjistër të pasurive, por ky regjistër nuk është i plotë. Në këtë regjistër i mungojnë informacionet si numri i bar kodit, kategoria dhe burimi i financimit. Përveç kësaj, regjistri i pasurive jo financiare në fund të vitit 2018 ka prezantuar vlerën neto prej 38,129€, ndërsa ato të marra vite me radhë si donacion, nuk janë regjistruar në për shkak të mos përgjigjes nga Komuna e Prishtinës.
- Rreziku** Një regjistër jo i plotë i pasurive pa të gjitha informacionet e nevojshme, ndikon që pasqyrat financiare të mos jenë të sakta dhe të besueshme. Po ashtu, mungesa e një marrëveshje me komunën për të drejtat dhe obligimet e pajisjeve të pranuar ka si rrezik që këto pajisje ende të mos regjistrohen dhe të mos vihen në përdorim.
- Rekomandimi A5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se mbahet regjistri i plotë i pasurive, se pasuritë kanë numrat përkatës identifikues, se është bërë klasifikimi i pasurive fikse duke mundësuar një menaxhim më të lehtë dhe me efikas të pasurive. Po ashtu, bordi duhet të mbajë takim me aksionarin për të hartuar një marrëveshje për të drejtat dhe obligimet që do të dalin lidhur me pasuritë e pranuar këtë vit dhe në vitet paraprake.



### 3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Ndërmarrja publike Hortikultura në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

**Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2018 (në €)**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2018</b>	<b>Viti 2017</b>
Të hyrat nga shitja	1,235,015	1,025,934
Të hyrat tjera nga donacionet	7,470	0
<b>Gjithsej të Hyrat</b>	<b>1,242,485</b>	<b>1,025,934</b>
Pagat dhe mëditjet	941,942	814,609
Shpenzimet e kontributeve te punëtoreve	47,098	40,731
Shpenzimet e automjeteve	9,293	5,667
Shpenzimet e mirëmbajtjes se parqeve	40,291	37,994
Shpenzimet e mirëmbajtjes se auto tregut	6,665	7,845
Shpenzimet tjera operative	33,049	24,852
Shpenzimet administrative	6,890	6,491
Shpenzimet e zhvlerësimit	11,498	11,978
Shpenzimet për kamate	811	8,033
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>1,097,537</b>	<b>958,200</b>
<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>	<b>144,948</b>	<b>67,734</b>
Tatimi në fitim	14,495	6,773
<b>Fitimi/Humbja neto</b>	<b>130,453</b>	<b>60,961</b>

---

**Çështja A6 - Shmangie e procedurave të prokurimit**

**Gjetja** Sipas Rregullave dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik pika 54.1, Autoriteti kontraktues mund ta përdorë procedurën me vlerë minimale për çdo kontratë publike vlera e përlogaritur e të cilës është më pak se 1,000€. Me dhënien e porosive për blerje në lidhje me prokurimin me vlerë minimale, Autoriteti kontraktues do të sigurojë një konkurrim efektiv, transparencë dhe efektivitet të lartë të përdorimit të fondeve publike.

Gjatë testimit të 19 mostrave, në 12 prej tyre kemi gjetur se ndërmarrja nuk ka zhvilluar fare procedura të prokurimit. Prej tyre nëntë (9) mostra ishin furnizime me mobile & inventar për zyre dhe tre (3) raste tjera pajisje të teknologjisë informative. Vlera totale e furnizimeve për mobile dhe inventar për zyre sipas faturimit është 860€, ndërsa vlera e pajisjeve të TI ishte 1,085€. Këto furnizime kanë qenë të planifikuara, por sipas zyrtarit të prokurimit nuk janë zhvilluar procedura të prokurimit për shkak se mobilet dhe pajisjet tjera janë blerë të kualitetit më të mirë nga operatori i përzgjedhur sesa nëse do të bliheshin përmes prokurimit.

**Rreziku** Blerja e mobilieve dhe pajisjeve tjera duke anashkaluar procedurat e prokurimit ka ndikuar në favorizimin e një operatori të caktuar ekonomik dhe ka dëmtuar konkurrencën e lirë dhe transparencën.

**Rekomandimi A6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se të gjitha blerjet që i nevojiten ndërmarrjes të planifikohen dhe pastaj të realizohen përmes procedurave adekuate të prokurimit duke pas parasysh konkurrencë e lirë dhe transparencën për të arritur vlerën e shtuar për para.

---

**Çështja A7 - Ndarje e procedurave të prokurimit për blerjen e furnizimeve të ndërlidhura****Gjetja**

Në Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik në nenin 10 parashihet që njësia kërkuese ka përgjegjësitë në vijim: a) Përgatit një kërkesë të prokurimit, bën vlerësimin formal të nevojave, dhe përcjellë këto të Zyrtari Kryesor Administrativ për aprovim; b) Përgatit/proponon specifikime teknike, Termat e Referencës, dhe Paramasën dhe Paralogarinë, dhe c) Siguron që nuk ka kufizime në specifikime. Gjatë testimit të procedurave të prokurimit kemi gjetur se në një rast është shpallur tender për projektin "Furnizim me pompë uji dhe montimi i saj" ku me datën 27.07.2018 është lidhur kontratë në shumë prej 2,454€ me një afat prej një muaji (27.07-27.08.2018). Ky afat nuk është përfillur pasi paramasa e përgatitur nuk ka përfshirë të gjitha pozicionet e mundshme të këtij projekti. Për kompletimin e këtij projekti, janë zhvilluar procedura me vlerë minimale për ato pozicione të cilat nuk janë paraparë në tenderin e parë, e që është shpërblyer i njëjti OE për 979€. Projekti i realizuar nuk ka qenë planifikuar në planin përfundimtar dhe si i tillë është zhvilluar me dy procedura: e para me procedurë të koutimit të çmimit dhe e dyta me vlerë minimale. Kjo për shkak së njësia kërkuese nuk ka specifikuar të gjitha pozicionet e mundshme për këtë projekt, si dhe zotimi fillestar për këtë projekt ishte vetëm 2,500€.

**Rreziku**

Mos përfshirja e të gjitha pozicioneve në specifikat teknike për projekt ka paraqitë nevojën për blerje të pjesëve shtesë me procedure tjetër prokuruese duke shkaktuar vonesa dhe shpenzime shtesë dhe ka rrezikuar menaxhimin e parasë publike në mënyrë jo racionale, në konkurrencën jo të mirëfilltë.

**Rekomandimi A7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se për çdo blerje që kërkon të zhvillohen procedura të prokurimit paraprakisht duhet të planifikohen, të shqyrtohen dhe të analizohen furnizimet si në aspektin teknik ashtu edhe në atë financiar e pastaj të zhvillohen procedurat adekuate të prokurimit të cilat mundësojnë realizimin e projektit me kosto me të ulët dhe konkurrencë të mirëfilltë.

---

**Çështja A8 - Kompensimi i honorarëve për anëtarët e bordit të drejtorëve pa miratimin e aksionarit**

**Gjetja** Sipas nenit 20.2 të Ligjit për Ndërmarrje Publike 03/L-087, pika (ii) Honorari themelor për drejtorët e Ndërmarrjes Publike (NP) do të përcaktohet me një vendim të komisionit përkatës Komunal të Aksionarëve. Po ashtu neni 20.6. parasheh se “NP është përgjegjëse për pagesën dhe kompensimin për drejtorët e saj vetëm nga pagesat e parapara me vendimin e aksionarit. Drejtorët e NP nuk do të marrin asnjë kompensim ose përfitim tjetër nga NP”. Mirëpo, gjatë rishikimit të pagesave për Bordin e Drejtorëve të Hortikultura, kemi vërejtur se janë bërë pagesa në kundërshtim me nenin në fjalë, për kompensim të honorarëve nga 50€ për çdo mbledhje të mbajtur shtesë, përveç asaj që është caktuar nga aksionari. Pagesat e tilla për mbledhjet e mbajtura për muajt nëntor/dhjetor 2018 arrijnë totalin 1,700€ (për katër anëtarët e bordit). Pagesat janë ekzekutuar sipas vendimit me nr. 3921 i datës 30.11.2018, i nxjerr nga Komisioni i Auditimit dhe pa miratimin paraprak të aksionarit. Këto pagesa janë bërë për shkak të punës së tyre shtesë, për hartimin e rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes.

**Rreziku** Pagesa të tilla në kundërshtim me ligjin si dhe ekzekutimi i vendimeve për pagesa shtesë pa aprovimin e aksionarit rrit rrezikun e menaxhimit jo të duhur të mjeteve financiare të Ndërmarrjes.

**Rekomandimi A8** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se vendimi për kompensimin e punëve shtesë të anëtarëve të bordit paraprakisht të jetë miratuar nga Aksionari, në të kundërtën të mos bëhen pagesa tjera përveç atyre që u takojnë si kompensime të rregullta.

## Çështja A9 - Dobësi në procedura të rekrutimit

### Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ (MPMS<sup>4</sup>) Nr. 07/2015 për rregullimin e procedurave të konkursit për sektor publik, neni 5 (pika 1.6) parasheh kohëzgjatjen e emërimit, një përshkrim nëse pozita është me afat të caktuar ose e përhershme si dhe kohëzgjatjen e periudhës provuese. Në bazë të rishikimit të konkursit të shpallur më datën 04.07.2018, për pozitën e një zyrtari certifikues dhe dy (2) kryepunëtor për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, kemi gjetur se konkursi nuk ka paraparë kohëzgjatjen e emërimit, pozitën me afat të caktuar si dhe kohëzgjatjen e periudhës provuese. Po ashtu sipas nenit 7, pika 1 organi përkatës në afat prej tre ditësh nga data e publikimit të konkursit publik, duhet të nxjerr vendimin për themelimin e komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, derisa themelimi i këtij komisioni nga kryeshefi ekzekutiv është bërë një muaj pas datës e publikimit të konkursit.

Për pozitën e zyrtarit certifikues të gjithë kandidatet që kishin konkurruar nuk i plotësonin kriteret e kërkuara me konkurs. Pavarësisht kësaj, është përzgjedhur njëri prej tyre, ndonëse nuk kishte dëshmi për përvojën e punës (që kërkohej minimumi tri vite) dhe nuk kishte letër motivuese. Neni 6, pika 5.1 i UA-së së lartpërmendur parasheh se, konkursi publik duhet të përsëritet nëse së paku tre nga kandidatet nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me konkurs. Sipas zyrtareve të ndërmarrjes konkursi nuk është përsëritur duke pasur parasysh nevojën për mbulimin e kësaj pozite në kohë më optimale.

Gjithashtu, në konkursin për pozitën kryepunëtor në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, kemi vërejtur që dy kandidatet e përzgjedhur në konkursin e shpallur me datë 04.07.2018, nuk i kanë plotësuar kriterin kryesor për përgatitje shkollore: shkolla e mesme drejtimi i pylltarisë ose i bujqësisë apo drejtimi përkatës. Kandidatët e përzgjedhur njëri kishte shkollën e mesme teknike ndërsa tjetri kishte shkollën e mesme ekonomike-juridike. Kjo ka ndodhur pasi që sipas komisionit nuk ka pasur kandidat të këtij profili dhe është vazhduar procesi me kandidatët ekzistues në mënyrë që ajo pozitë të mos mbetet e pa plotësuar.

### Rreziku

Dobësitë në procesin e rekrutimit mund të rezultojnë me konkurrencë të padrejtë, jo transparencë si dhe punësim të personelit me profil jo adekuat.

### Rekomandimi A9

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që përzgjedhjet e kandidatëve në proceset e rekrutimit bëhen duke i respektuar të gjitha kërkesat e konkursit dhe atëherë kur në garë janë më pak se tre kandidat të anulohet ai proces dhe të rishpallet përsëri.

<sup>4</sup> MPMS - Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

### 3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të Ndërmarrjes, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

**Tabela 4: Kapitali i Ndërmarrjes publike më 31.12.2018** (në €)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>KAPITALI</b>	<b>511,280</b>	<b>380,827</b>
Kapitali aksionar	10,000	10,000
Kapitali rezervë	111,721	111,721
Fitimet/Humbjet e bartura	259,107	198,146
Fitimet/Humbja e vitit aktual	130,452	60,960

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve operative, investuese dhe ato financuese. Informatat rreth rrjedhës së parave të ndërmarrjes janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

**Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme** (në €)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Arkëtimet nga llogarite e arketueshmeve	1,412,964	1,257,406
Pagesat për paga	986,023	844,976
Pagesa për tatime dhe tvsh	161,346	277,686
Pagesa ndaj furnitorëve	131,714	62,920
<b>Rrjedha neto nga aktivitetet operative</b>	<b>133,881</b>	<b>71,824</b>
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investues</i>		
Arkëtimi nga shitja e pasurive	0	0
Pagesa për blerjen e pasurive jo qarkulluese	0	0
<b>Paratë neto nga aktivitetet investuese</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet nga aktivitetet financuese	<b>0</b>	<b>0</b>

<b>Paratë neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Paraja në fillim të vitit	175,294	103,470
<b>Paraja në fund të vitit</b>	<b>309,175</b>	<b>175,294</b>

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

---

**Çështja A10 - Mos prezantimi i plotë i shënimeve shpjeguese****Gjetja**

Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë i pasqyrave financiare duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese. Ne me rastin e rishikimit të shënimeve shpjeguese kemi vërejtur:

- Në shënimin 7, detyrimet tatimore shuma e prezantuar 9,389€ si obligim i tatimit në fitim nuk korrespondon me shënimet e ATK-se pasi që shuma e cila është llogaritur në bazë të shënimeve të ATK-së është 8,930€ që do të thotë se kemi një mbivlerësim të obligimeve për 459€. Ne nuk kemi gjetur ndonjë shënim shpjegues tjetër për të vërtetuar gabimin e llogaritur nga Hortikultura;
- Në shënimin 13, janë prezantuar zërat për kapital themelues në shumë prej 121,727€, por mungojnë të dhënat krahasuese për vitin 2017;
- Në shënimin 14 zotimet dhe kontingjentet është dhënë një përshkrim se ndërmarrja nuk ka detyrime kontingjente në dy vitet e fundit. Ndërsa në raportet e tremujorit të dytë është përmendur së në këtë periudhë janë zhvilluar dy seanca për lëndë penale dhe një për lëndë civile, të cilat ndërmarrja nuk i ka prezantuar në shënimet shpjeguese të PFV-ve.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos kujdesit dhe rishikimit të duhur gjatë përgatitjes së shënimeve shpjeguese.

**Rreziku**

Mos prezantimi i saktë dhe i plotë i shënimeve shpjeguese mund të shkaktoi paqartësi tek lexuesit dhe aksionari lidhur me përmbajtjen e PFV-ve dhe ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë vitit.

**Rekomandimi A10** Kryesuesi Bordit duhet të siguroj se shënimet shpjeguese kanë një rol të veçantë dhe japin informata të mjaftueshme për të gjithë zërat, përfshirë zërat e obligimeve tatimore dhe detyrimeve kontingjente si dhe të sigurojë paraqitjen e të dhënave krahasuese për kapitalin themelues.



## 4 Qeverisja e mirë

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Hortikultura ka shënuar progres të mirë në sajë të auditimit të kryer nga ZKA për vitin paraprak si dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga vitet paraprake. Edhe në këtë vit është shënuar progres në raportimin menaxherial dhe llogaridhënie. Përkundër progresit të arritur, për një qeverisje edhe më të mirë menaxhmenti duhet t'i kushtoj kujdes të duhur funksionalizimit të komisionit të auditimit dhe kontrollit të brendshëm lidhur me çështjet e ngritura në këtë raport.

---

## 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një stafit i cili njëkohësisht është Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare të ndërmarrjes dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit. NJAB ka hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2018 dhe ka planifikuar tetë (8) auditime, ku gjashtë (6) prej tyre janë realizuar. Prej auditimeve të kryera katër (4) janë të vitit 2018 dhe dy (2) të tjera janë për periudhën e vitit 2017. Përmes këtyre raporteve NJAB i kishte ofruar informata menaxhmentit se sa efektive janë kontrollet e brendshme dhe funksionimi i tyre.

---

### Çështja C1 - Mungesa e komisionit të auditimit

**Gjetja** Sipas Ligjit për ndërmarrje publike Nr. 03/L -087 neni 24, kërkon që ndërmarrja të ketë komisionin e auditimit i cili ka autorizimet e veta që burojnë nga ligji për miratimin e planeve dhe mbikëqyrjen e punëve të NJAB-ës. Hortikultura ishte pa Bord të drejtorëve dhe pa komision të auditimit që nga viti 2014 deri në shtator 2018. Kjo ka reflektuar, përveç tjerash, tek rishikimi dhe miratimi i planeve vjetore të auditimit të brendshëm. Megjithatë, auditori i brendshëm kishte hartuar planet e auditimit duke bërë përpjekje të bazohet në rreziqet që i ka ndërmarrja, mirëpo këto plane ishin të pa miratuara nga komisioni i auditimit. Gjithashtu edhe raportet e auditimit të brendshëm ishin të pa shqyrtuara nga komisioni i auditimit. Kjo për shkak të mungesës së komisionit të auditimit që nga viti 2014 të cilin nuk e kishte themeluar komiteti komunal i aksionarëve deri në shtator 2018.

**Rreziku** Mungesa e gjatë e formimit të bordit të drejtorëve dhe e komisionit të auditimit kishte ndikuar në dobësimin e kontrolleve të brendshme dhe në adresimin e përgjegjësive lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

**Rekomandimi C1** Kryesuesi i Bordit për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, përmes komisionit të auditimit duhet të rishikoj në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe që përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual. Po ashtu, të gjitha raportet e auditorit të brendshëm të shqyrtohen dhe merren veprimet konkrete për adresimin e rekomandimeve për t'i ndihmuar menaxhmentit të ndërmarrjes në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të saj.

---

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë ndërmarrjen.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuar janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja B3 - Sistemi për menaxhimin e rrezikut

**Gjetja** Sipas Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative të ndërmarrjeve publike, bordi i drejtoreve duhet t'i rishikoj rreziqet kryesore në biznes, të sigurohet që janë të vendosura menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli, dhe t'i rishikoj në baza të rregullta në dritën e ndryshimeve dhe objektivave strategjike të ndërmarrjes. Hortikultura nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsisë. Për më tepër, nuk ka ndonjë regjistër ku identifikohen dhe vlerësohen rreziqet e mundshme që e kërcënojnë Ndërmarrjen, si dhe parashihen veprimet e menaxhmentit për të zvogëluar ato në nivel të pranueshëm. Shkaku i mos posedimit të një regjistri të rreziqeve ishte mungesa e bordit të drejtoreve që nga vitit 2013 e deri në shtatori 2018.

**Rreziku** Mungesa e një regjistri të rreziqeve mund të ketë ndikim që menaxhmenti të mos identifikoj dhe të menaxhoj rreziqet me kohë, e në këtë kontest të mos arrijë objektivat e saj strategjike.

**Rekomandimi B3** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë masa për formimin e komisionit për hartimin e një liste me të gjitha rreziqet e mundshme e cila do të shfrytëzohet si mjet parandalues dhe menaxhim të rrezikut në nivele sa më të menaxhueshëm. Kjo do t'i kontribuoj efektivitetit më të lartë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të Hortikulturës ka rezultuar me 19 rekomandime kryesore. Menaxhmenti kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, 13 rekomandime janë zbatuar, tre (3) ishin në proces dhe tre (3) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejte dhe të vërtetë të tyre.</p> <p>Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD.</p>	Menaxhmenti ka marrë veprim lidhur me korrigjimin e PFV të vitit 2017, por ende kanë mbetura çështja e donacioneve dhe objektit të zyrave të pa trajtuara.	Rekomandimi pjesërisht i zbatuar.
2	Plani i biznesit (të hyrat dhe shpenzimet)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që plani i biznesit bazohet në mundësitë reale të ndërmarrjes dhe realizimi i të hyrave monitorohet në mënyrë sistematike dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar të reflektohen në një plan të rishikuar.	Është marrë parasysh ky rekomandim dhe plani fillestar dhe ai rishikuar reflektojnë ndryshimet e duhura.	Rekomandimi i zbatuar.

3	Pasqyra e pozitës financiare (Bilanci i gjendjes)	Kryesuesi i Bordit duhet të nxjerrë një rregullore për menaxhimin e llogarive të arkëtueshmeve, duke përcaktuar procedura dhe kontrole të qarta dhe kjo të jetë në harmoni me standardet dhe rregullat në fuqi. Gjithashtu, Bordi duhet të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të këtyre llogarive dhe në rastet kur janë plotësuar kushtet ligjore të aplikoj ndëshkimet ndaj klientëve dhe ato të evidentohen si llogari e arkëtueshme. Po ashtu, duhet të sigurojë që të gjitha llogaritë e arkëtueshme prezantohen në PFV.	Bordi i drejtoreve ka hartuar Rregulloren për provizione të llogarive të arkëtueshmeve me 31.12.2018.	Rekomandim i zbatuar.
4	Pasqyra e pozitës financiare (Bilanci i gjendjes)	Kryesuesi i Bordit duhet që të siguroj që brenda një afati sa më të shkurtër të hartoj një rregullore të brendshme mbi menaxhimin e pasurive, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për përdorimin e pasurive (të drejtat dhe detyrimet e stafit). Po ashtu, të sigurojë një marrëveshje të qartë me Komunën e Prishtinës në të cilën do të definohen të drejtat dhe obligimet e palëve dhe të ndërmarre veprimet e nevojshme lidhur me trajtimin e këtyre pasurive sipas SNK-ve.	Bordi i drejtoreve ka hartuar Rregulloren për menaxhimin e pasurive me 31.12.2018, megjithatë ende nuk ka marrëveshje me komunën e Prishtinës për të drejtat dhe obligimet për pajisjet dhe makineritë e marra si donacion.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
5	Pasqyra e pozitës financiare (Bilanci i gjendjes)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është hartuar një rregullore që përcakton procedurat dhe mënyrën e përdorimit të arkës duke përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve përkatës.	Bordi ka hartuar Rregulloren për menaxhimin e arkës me 31.12.2018.	Rekomandim i zbatuar.
6	Pasqyra e pozitës financiare (Bilanci i gjendjes)	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë veprimet e nevojshme për t'i korrigjuar shënimet kontabël dhe të siguroj prezantim të saktë në PFV.	Është bërë një përmirësim por ende ka çështje.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
7	Pasqyra e pozitës financiare (Bilanci i gjendjes)	Kryesuesi i Bordit duhet të merr masa të menjëhershme për pagesën e faturave duke i bërë pagesat e faturave brenda afateve ligjore, me qëllim që tu shmanget shpenzimeve shtesë.	Është marrë në konsideratë ky rekomandim.	Rekomandim i zbatuar.
8	Pasqyra e të ardhurave	Kryesuesi i Bordit të nxjerrë një rregullore për menaxhimin e të hyrave, duke	Bordi ka hartuar një Rregullore	Rekomandim i zbatuar.

	dhe shpenzimeve	përcaktuar procedura dhe kontrolle të qarta, në harmoni me standardet dhe rregullat në fuqi. Ndërsa, me rastin e përgatitjes së ofertës për shërbime për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese, vlera e ofertës të jetë në harmoni me kërkesën për punë.	për të hyrat me 31.12.2018.	
9	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që zyrtarët e lartë të Ndërmarrjes kanë kontrata të marrëdhënies së punës për të siguruar funksionimin e mirëfilltë të Ndërmarrjes.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura.	Rekomandim i pa zbatuar.
10	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit të siguroj që secili i punësuar në ndërmarrje të ketë kontratë të punës në pajtim me kërkesat ligjore dhe procedurale në fuqi.	Është marrë vendimi për kontratë për zyrtarin e prokurimit.	Rekomandim i zbatuar.
11	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që blerjet e mallrave dhe shërbimeve bëhen në harmoni të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik në mënyrë që të shmangët diskriminimi apo favorizimi i operatorëve ekonomik dhe të sigurohet shfrytëzimi efikas i fondeve publike.	Nuk është marrë në konsideratë ky rekomandim pasi edhe në vitin 2018 ka pasur rastet të tilla.	Rekomandim i pa zbatuar.
12	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që në procesin e hapjes së tenderëve të jenë të përfshirë personat përgjegjës dhe të caktuar me anë të vendimit. Në rast të pamundësisë së zbatimit të vendimit, duhet t'i reflektoj ndryshimet përmes shfuqizimit dhe aprovimit të vendimit tjetër.	Është marrë parasysh ky rekomandim.	Rekomandim i zbatuar.
13	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një ri strukturim të stafit duke vendosur zyrtarin certifikues dhe të sigurojë ndarje të duhur të detyrave për të siguruar kontrolle efektive në procedimin e pagesave.	Po, është caktuar zyrtari certifikues në vitin 2018.	Rekomandim i zbatuar.
14	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Është marrë parasysh ky rekomandim.	Rekomandim i zbatuar.
15	Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të siguroj që Komisioni i Auditimit (pas përzgjedhjes) rishikon në mënyrë kritike	Janë ndërmarrë masa lidhur me këtë rekomandim.	Rekomandim i zbatuar.

		planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe që përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual.		
16	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i Bordit duhet që të zgjedhë sa më parë Komisionin e Auditimit, që të ushtrojë detyrat në funksion të zbatimit të ligjit dhe të forcimit të kontrolleve të brendshme në ndërmarrje.	Është caktuar komisioni i auditimit.	Rekomandimi i zbatuar.
17	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.	Ne vitin 2018 nuk është zbatuar por për vitin 2019.	Rekomandimi pa zbatuar.
18	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e masave të nevojshme për të hartuar dhe miratuar një kod të etikës sipas kërkesave të ligjit për NP-të dhe e nënshkruajnë të gjithë drejtoret e ndërmarrjes.	Po është hartuar kodi i etikës me 31.12.2018	Rekomandimi i zbatuar.
19	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të krijojë një ueb-faqe të internetit të ndërmarrjes dhe të publikojë të gjitha rregulloret, raportet dhe dokumentet që i kërkon Ligji i Ndërmarrjeve Publike, për qëllim të transparencës ndaj publikut.	Po është zbatuar ky rekomandim, pasi që tani ekziston ueb-faqja e internetit.	Rekomandimi i zbatuar.
	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018 (këtu vendosen të gjitha rekomandimet e dhëna për vitin 2018)		
1	PVF	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se të gjitha aktivitetet e kontrolluara nga ndërmarrja dhe nga të cilat parashikon përfitime ekonomike duhen të prezantohen në PVF.		
2	PVF	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se në bashkëpunim me menaxhmentin e komunës së Prishtinës dakordohen për një marrëveshje lidhur me përcaktimin e të drejtës dhe obligimet për pasurit e pranuar/dorëzuara si donacion.		
3	PVF	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se hapësira për zyre që e shfrytëzon Hortikultura edhe pse është pronë e Komunës së Prishtinës, kostoja e saj duhet të njihet, të matet dhe të regjistrohet si pasuri e ndërmarrjes në përputhje me SNK 20.		
4	Plani i biznesit	Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë një vlerësim sistematik të arsyeve për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për shpenzimet operative dhe të përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e ekzekutimit në bazë të një analize me të hollësishme rreth planifikimit dhe realizimit të buxhetit.		
5	Pasqyra e pozitës	Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë veprime konkrete për parandalimin e avancave ndaj punëtorëve dhe të ndërpresë një praktike të tillë pa bazë		

	financiare	ligjore.
6	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroi që zyra e financave regjistrojnë të gjitha transaksionet në mënyrë të drejtë, duke interpretuar drejtë standardet e kontabilitetit, dhe të bëhen rregullimet e nevojshme duke bërë prerjen/regjistrimin e shpenzimeve të cilat i takojnë vetëm periudhës kontabël.
7	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se mbahet regjistri i plotë i pasurive, se pasuritë kanë numrat përkatës identifikues, se është bërë klasifikimi i pasurive fikse duke mundësuar një menaxhim më të lehtë dhe me efikas të pasurive. Po ashtu, bordi duhet të mbajë takim me aksionarin për të hartuar një marrëveshje për të drejtat dhe obligimet që do të dalin lidhur me pasuritë e pranura këtë vit dhe në vitet paraprahe.
8	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se të gjitha blerjet që i nevojiten ndërmarrjes të planifikohen dhe pastaj të realizohen përmes procedurave adekuate të prokurimit duke pas parasysh konkurrencë e lirë dhe transparencën për të arritur vlerën e shtuar për para.
9	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se për çdo blerje që kërkon të zhvillohen procedura të prokurimit paraprakisht duhet të planifikohen, të shqyrtohen dhe të analizohen furnizimet si në aspektin teknik ashtu edhe në atë financiar e pastaj të zhvillohen procedurat adekuate të prokurimit të cilat mundësojnë realizimin e projektit me kosto me të ulët dhe konkurrencë të mirëfilltë.
10	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se vendimi për kompensimin e punëve shtesë të anëtarëve të bordit paraprakisht të jetë miratuar nga Aksionari, në të kundërtën të mos bëhen pagesa tjera përveç atyre që u takojnë si kompensime të rregullta.
11	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që përzgjedhjet e kandidatëve në proceset e rekrutimit bëhen duke i respektuar të gjitha kërkesat e konkursit dhe atëherë kur në garë janë më pak se tre kandidat të anulohet ai proces dhe të rishpallet përsëri.
12	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi Bordit duhet të siguroj se shënimet shpjeguese kanë një rol të veçantë dhe japin informata të mjaftueshme për të gjithë zërat, përfshirë zërat e obligimeve tatimore dhe detyrimeve kontingjente si dhe të sigurojë paraqitjen e të dhënave krahasuese për kapitalin themelues.
13	Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i Bordit për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, përmes komisionit të auditimit duhet të rishikoj në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe që përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual. Po ashtu, të gjitha raportet e auditorit të brendshëm të shqyrtohen dhe merren veprimet konkrete për adresimin e rekomandimeve për t'i ndihmuar menaxhmentit të ndërmarrjes në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të saj.
14	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe manaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë masa për formimin e komisionit për hartimin e një liste me të gjitha rreziqet e mundshme e cila do të shfrytëzohet si mjet parandalues dhe menaxhim të rrezikut në nivele sa me të menaxhueshëm. Kjo do t'i kontribuoj efektivitetit më të lartë të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.



## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit


157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letër Konfirmimi



**"HORTIKULTURA" SH.A.**  
**PRISHTINË**

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2018 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ndërmarrjes Publike Hortikultura sh.a, për vitin 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do të ju dërgojmë të plotësuar pyetësorin për vlerësimin e subjektit të auditimit. Këtë pyetësor do të pranoni me letër përcjellëse të raportit final të auditimit.

Z. Shpetim Aliu ..... 

Kryesues i Bordit të Drejtorëve,

Data: 12. qershor 2019, Prishtinë.